

KLSH merr pjesë në tryezën e rrumbullakët “Angazhimi i shoqërisë civile për të rritur rolin dhe ndikimin e SAI-ve” organizuar nga SIGMA

Sarajevë, 5-6 qershor 2023

Në datat 5-6 qershor 2023 u organizua në Sarajevë, tryeza e rrumbullakët “Angazhimi i shoqërisë civile për të rritur rolin dhe ndikimin e SAI-ve”.

Në këtë aktivitet merrnin pjesë përfaqësues të SAI-ve të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Serbisë, Moldavisë, Ukrainës, Suedisë, Letonisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës. Gjithashtu pjesë e tij ishin edhe përfaqësues të disa prej shoqatave dhe Organizatave Jo Qeveritare të Malit të Zi dhe Bosnjë Hercegovinës, me të cilët u shkëmbyen ide dhe këndvështrime për përmirësimin e marrëdhënieve të SAI-ve me palët e interesit.

Në fokus të zhvillimeve të aktivitetit ishte prezantimi i Draft Raportit të përgatitur nga SIGMA mbi “Rritjen e impaktit përmes përfshirjes së jashtme” raport që në thelb trajton marrëdhënien efektive midis Institucioneve Supreme të Auditimit dhe palëve të jashtme të interesit, si dhe rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve dhe palëve të interesit në procesin e auditimit.



Në vijim të prezantimit të Draft Raportit të përgatitur nga SIGMA u diskutuan edhe aspekte të ndryshme që mund të përmirësohen dhe përditësohen në versionin final të tij, si dhe u prezantuan praktikatat e SAI-ve pjesëmarrëse (rasti i SAI-t të Suedisë dhe Letonisë), të cilat treguan mbi përfshirjen

e ekspertëve të jashtëm në auditime specifike, diskutimin në vazhdimësi me palët e interesit (akademikë, shoqata, institucione publike/private, gazetarë, profesionistë, etj.) duke mirëpritur tema dhe çështje të mundshme auditimi. Një vend të veçantë zuri dhe trajtimi i komunikimit të auditimeve nëpërmjet platformave të ndryshme elektronike, si dhe ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve.

KLSH u përfaqësua në këtë takim nga z. Alfred Zylfi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës dhe z. Aulent Guri, Kryeauditues në këtë Departament.